Republika e Kosovës	Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale		Komuna e Istogut
	06 Nr.574/2021	Data: 09.07.2021	

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE-ISTOG

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212 e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës shpallë:

KONKURS PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

Titulli i vendit të punës: Mjek-e i/e Mjekësisë së Përgjithshme
Numri i referencës: 06.nr.574-021
Numri i Ekzekutuesve 3 (tre)
Niveli i Pagës: Koeficienti 565€
Kohëzgjatja e Emërimit: Me afat të caktuar – 1 (një) vit
Orët e Punës: 40 Orë

Punët dhe detyrat:
1. Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen parësore;
2. Kujdesi për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanet, medikamentët dhe i zbaton masat tjera shëruese;
3. Ndihmon në parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët dhe popullatën në lidhje me pastërtinë dhe shëndetin në përgjithësi;
4. Jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtim të pacientit;
5. Përshkruan dhe administron medikamente;
6. Udhëzon pacientët të specialistët mjekësorë dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore
7. Përpilon me shkrim raportet lidhur me punën dhe veprimet e tij;
8. Ndërmerr aktivitetet për edukimin shëndetësorë të popullatës;
9. Kryen dëtyra të tjera ashtu si kërkon mbikqyrësi në mbarëvajtjen e punës ku është i punësuar;
10. Ndihmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veqant në lëmin në të cilin është trajnuar
11. Mban kujdestarinë sipas radhës dhe kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;
12. Kryen detyra të veqanta në lidhje me profesionin e tij.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare- Fakulteti i Mjekësisë drejtimi Mjekësia e Përgjithshme.

Aftësit/ përvoja dhe atributet e tjera:
1. Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
2. Të jetë i licencuar;
3. Përvoja e punës e dëshirueshme;
4. Shkathtësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
5. Shkathtësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe dhënja e këshillave profesionale;
6. Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
7. Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

REPUBLIC OF KOSOVA * REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA * OPSTINA *
ARHIVA / ARH

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
Çertifikatën e Licencës;
Dëshmi për përvojen e punës nëse ka;
Dokumenti i Identifikimit;
Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike , kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.
Konkursi mbetet i hapur **15 ditë nga dita e shpalljës** në mjetet e informimit.
Kandidatët e interesuar mund ti marrin aplikacionet çdo ditë pune në **Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare –Istog** -Zyra e Shërbimit Juridik dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen në të njejtën zyre.
Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahët intervista nga komisioni .
Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

D R E J T O R I
Dr. Ymer Vuthi